



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE

REKTORATI

DREJTORIA E MENAXHIMIT TE BURIMEVE NJERËZORE SJIP-A

Nr 838 Prot.

Tiranë, më 17/04 2026

Agjencisë së Prokurimit Publik

Tiranë

Lënda: Botim njoftimi në Buletinin e Njoftimeve Publike

Rektorati i Universitetit të Arteve, shpall konkursin për 3 (tre) vende të lira pune sa më poshtë:

FAKULTETI I ARTEVE TË BUKURA

➤ **NJËSIA BAZË SKULPTURË – 2 (dy) punonjës mësimor nga kategoria:**

1. Lektor /As. Lektor, në programin e studimit Skulpturë Qeramikë, për lëndën Vizatim - 1 (një) punonjës;
2. Lektor / As. Lektor, në programin e studimit Skulpturë Qeramikë, për lëndën Teknologji e Qeramikës - 1 (një) punonjës.

➤ **NJËSIA BAZË PIKTURË – 1 (një) punonjës mësimor nga kategoria:**

3. Lektor/As. Lektor, në programin e studimit Pikturë Monumentale, për lëndën Konservim-Restaurim - 1 (një) punonjës.

I.KRITERET E PËRGJITHSHME

1. Të jetë shtetas shqiptar.
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
3. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
4. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo kundërvajtje penale me dashje.
5. Të mos ketë marrë ndonjë masë disiplinore për largim nga detyra.
6. Vetë deklaram që nuk është dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata;
7. Dëshmi e gjendjes mjekësore.
8. Fotokopje të letërnjoftimit ose pasaportës;
9. Çertifikatë familjare;



II. KRITERE TË VEÇANTA:

Kandidati duhet të dorëzojë pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, këto dokumente:

III/1. Dokumentacioni që duhet të plotësojë çdo kandidat, për pozicionin e punës: “Lektor” / “As. Lektor” në Programin e studimit Skulpturë Qeramike, në lëndët: Vizatim.

Kandidati për konkursin duhet të plotësojë këto kritere:

- a. Kërkesë nga i interesuari ku të jetë përcaktuar pozicioni i punës për të cilin ai konkuron;
- b. Jetëshkrim (CV) shoqëruar me dokumentacionin përkatës, që vërteton elementët e paraqitur në të (studimet; aktiviteti artistik; përvoja pedagogjike si dhe çmimet dhe vlerësimet, etj.);
- c. Kandidati duhet të ketë përfunduar studimet universitare, në fushën e Arteve Pamore në një institucion të arsimit të lartë, të akredituar brenda ose jashtë vendit, në programin Skulpturë, preferohet me mesatare të përgjithshme mbi 8, për këtë kriter kandidati duhet të dorëzojë diplomë + listë notash/fotokopje e noterizuar;
- d. Preferohet të ketë përfunduar ose të jetë në proces të studimeve të Ciklit të Tretë të Studimeve – “Doktor” në specialitetin për të cilin konkurren;
- e. Të ketë të paktën, 3 (tre) vite pune në mësimdhënie, në Institucione të Arsimit të Lartë, për këtë kriter kandidati duhet të dorëzojë librezën e punës të noterizuar;
- f. Të ketë aktivitete të dokumentuara me katalogë, artikuj, postera, portofol artistik apo botime etj.;
- g. Të jetë pjesëmarrës në takime e konferenca, workshope kombëtare dhe ndërkombëtare me institucione të fushës;
- h. Të ketë dëshmi të dokumentuara për angazhim praktik ose profesional në fusha që lidhen drejtpërdrejt me Skulpturë Qeramikë;
- i. Të jetë i/e aftë të punojë në grup dhe të ndajë informacionin e fituar me kolegët e tjerë dhe të dëshmojë etikë të lartë profesionale;
- j. Preferohet që kandidati të zotërojë Dëshmi të Gjuhës së huaj sipas kërkesave standard të Ministrisë së Arsimit;
- k. Dy referenca nga profesorë/personalitete të fushës;

IV/1. Dokumentacioni që duhet të plotësojë çdo kandidat, për pozicionin e punës: “Lektor” / “As. Lektor” në Programin e studimit Skulpturë Qeramike, në lëndën: Teknologji e Qeramikës.

Kandidati për konkursin duhet të plotësojë këto kritere:

- a. Kërkesë nga i interesuari ku të jetë përcaktuar pozicioni i punës për të cilin ai konkuron;



- b. Jetëshkrim (CV) shoqëruar me dokumentacionin përkatës, që vërteton elementët e paraqitur në të (studimet; aktiviteti artistik; përvoja pedagogjike si dhe çmimet dhe vlerësimet, etj.);
- c. Kandidati duhet të ketë përfunduar studimet universitare, në fushën e Arteve në një institucion të arsimit të lartë, të akredituar brenda ose jashtë vendit, në programin Skulpturë, preferohet me mesatare të përgjithshme mbi 8, për këtë kriter kandidati duhet të dorëzojë diplomë + listë notash/fotokopje e noterizuar;
- d. Preferohet të ketë përfunduar ose të jetë në proces të studimeve të Ciklit të Tretë të Studimeve – “Doktor” në specialitetin për të cilin konkurron;
- e. Të ketë njohuri të avancuara mbi proceset teknologjike dhe teknike të Qeramikës;
- f. Të njohë linjën e prodhimit të argjilës (baraban, filtër presë, vakum presë), të njohë proceset e allçisë (tornim, derdhje, formim), të njohë njohë proceset e glazurimit dhe të pjekjes;
- g. Kandidati duhet të ketë eksperiencë pune në këtë profil jo më pak se 3 (tre) vite, për këtë kriter kandidati duhet të dorëzojë librezën e punës të noterizuar;
- h. Të njohë programet e avancuara kompjuterike të modelimit 2D dhe 3D, për përfshirjen në procesin krijues dhe pedagogjik, e cila konsiderohet komponent thelbësor i edukimit bashkëkohor, në fushën e Skulpturës Qeramike;
- i. Të ketë aktivitete të dokumentuara me katalogë, artikuj, postera, portofol artistik apo botime etj.;
- j. Të ketë vlerësime pozitive pune nga punëdhënësi;
- k. Preferohet që kandidati të zotërojë Dëshmi të Gjuhës së huaj sipas kërkesave standard të Ministrisë së Arsimit;
- l. Dy referenca nga profesorë/personalitetet e fushës;

V/1. Dokumentacioni që duhet të plotësojë çdo kandidat, për pozicionin e punës: “Lektor” / “As. Lektor” në Programin e studimit Pikturë Monumentale, në lëndën: Konservim-Restaurim.

Kandidati për konkursin duhet të plotësojë këto kriteret:

- a. Kërkesë nga i interesuari ku të jetë përcaktuar pozicioni i punës për të cilin ai konkurron;
- b. Jetëshkrim (CV) shoqëruar me dokumentacionin përkatës, që vërteton elementët e paraqitur në të (studimet; aktiviteti artistik; përvoja pedagogjike si dhe çmimet dhe vlerësimet, etj.);
- c. Kandidati duhet të ketë përfunduar studimet universitare, në fushën e Arteve Pamore dhe/ose Biologji Kimi në një institucion të arsimit të lartë, të akredituar brenda ose jashtë vendit, studime të cilat janë thelbësore për proceset shkencore dhe teknike të konservimit dhe restaurimit të veprave të artit, preferohet me mesatare të përgjithshme mbi 8, për këtë kriter kandidati duhet të dorëzojë librezën e punës të noterizuar;
- d. Preferohet të ketë përfunduar Ciklin e Tretë të Studimeve – “Doktor” në specialitetin për të cilin konkurron;
- e. Të ketë të paktën 3 (tre) vite përvojë pune në mësimdhënie, në Institucionet e Arsimit të Lartë, për këtë kriter kandidati duhet të dorëzojë librezën e punës të noterizuar;
- f. Të ketë aktivitete të dokumentuara me katalogë, artikuj, postera, portofol artistik apo botime etj.;



- g. Të ketë dëshmi të dokumentuara për angazhimin praktik ose profesional në fusha që lidhen drejtpërdrejtë me restaurimin dhe konservimin e veprave të Artit;
- h. Të ketë njohuri në përpunimin e dokumentacionin dixhital përkatës Konservues/Restaurues;
- i. Të jetë i/e aftë të punojë në grup dhe të ndajë informacionin e fituar me kolegët e tjerë;
- j. Preferohet që kandidati të zotërojë Dëshmi të Gjuhës së huaj sipas kërkesave standard të Ministrisë së Arsimit;
- k. Dy referenca nga profesorë/personalitate te fushës;

VI. KONKURRIMI PËR PUNONJËS MËSIMORË SA MË LARTË DO TË ZHVILLOHET NË TRE FAZA: (Vlerësimi maksimal 100 pikë)

- | | | |
|--------------------------|--|------------------------------|
| 1.1. Faza e parë | Shqyrtimi i dosjes së kandidatit. | (Vlerësimi gjithsej 40 pikë) |
| 1.2. Faza e dytë | Intervistë e strukturuar me gojë | (Vlerësimi gjithsej 20 pikë) |
| 1.3. Faza e tretë | Mësim i Hapur | (Vlerësimi gjithsej 40 pikë) |

Dosjet e kandidatëve do të dorëzohen në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Universitetin e Arteve nga data, 27/04/2026 deri më datë 10/05/2026 ora **14.00**.

Për datën e Konkursit kandidatët do të informohen pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore SJ&IP-A, çdo ditë nga ora **08.00** deri **14.00**.

Prof. Dr. Eralt BAKALLI

REKTOR
UNIVERSITETI I ARTEVE

